



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY



Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) – Rruga Migjeni (ish Banka e Ljublanës), Kati V-të, Prishtinë, Kosovë
Tel: 383 38 312 309 email: oshp@rks-gov.net

OSHP: 2025/0053
Data e Vendimit: 05.02.2025

Në bazë të nenit 105 pika 1 dhe 2, të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 05/L-068, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 05/L-092, si dhe nenit 17 paragrafi 6 i Rregullores së Punës së OSHP-së nr. 01/2020, pas shqyrtimit të ankesës së Operatorit Ekonomik (OE) “DWH-Kosova” SH.P.K kundër vendimit të AK-së lidhur me aktivitetin e prokurimit: “Blerja e paisjes për matje te gjeodezike për nevojat e drejtorisë” me numër prokurimi 624-24-10705-1-3-6, inicuar nga autoriteti kontraktues (AK) – Komuna Suharekë, U.D Kryesuesi i Sekretariatit të OSHP-së, z. Agim Sheqiri me datën: 05.02.2025, mori këtë:

Vendim

I. Hedhet e jashtafatshme ankesa e OE “DWH-Kosova” SH.P.K me nr. të protokollit 2025/0053, e datës 17.01.2025, e parashtruar për aktivitetin e prokurimit “Blerja e paisjes për matje te gjeodezike për nevojat e drejtorisë” me numër prokurimi 624-24-10705-1-3-6, inicuar nga autoriteti kontraktues (AK) – Komuna Suharekë, në cilësi të AK-së.

II. I lejohet, autoritetit kontraktues- Komuna Suharekë që të vazhdojë më tutje me aktivitetin e prokurimit si në pikën itë dispozitivit, përkitazi me këtë ankesë, nëse nuk ka ndonjë ankesë tjetër për këtë aktivitet.

III. Në përputhje me nenin 31 pika 4, të Rregullores së Punës së OSHP-së, operatorit ekonomik ankues i kthehet tarifa e ankesës në shumën e deponuar me rastin e parashtrimit të ankesës. OE ankues obligohet që konform nenit 31 pika 6 të Rregullores së Punës së OSHP-së, në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh të bëjë kërkesë për kthim të sigurimit të ankesës, në të kundërtën i bëhet konfiskimi i depozitës, dhe këto mjete kalojnë Buxhetin e Republikës së Kosovës.

Arsyetim

-Faktet dhe rrethanat procedurale -

Organi Shqyrtues i Prokurimit në sistemin elektronik me datë 17.01.2025, ka pranuar ankesën e OE “DWH-Kosova” SH.P.K lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “Blerja e paisjes për

matje te gjeodezike për nevojat e drejtorisë” me numër prokurimi 624-24-10705-1-3-6, inicuar nga autoriteti kontraktues (AK) – Komuna Suharekë në cilësinë e Autoriteti Kontraktues.

Me 14.10.2024, Komuna Suharekë në cilësinë e Autoritetit Kontraktues ka publikuar njoftimin për kontratë ndërkaq me datën 24.12.2024 është publikuar njoftimi për anulim të aktivitetit të prokurimit.

Operatori Ekonomik “DWH-Kosova” SH.P.K me datën 31.12.2024 ka parashtruar kërkesë për rishqyrtim në AK.

Ankuesi (me të dhëna si më lartë) ka parashtruar ankesë në OSHP me datën 07.01.2025 me numër protokoli 2025/0025 e cila është hedhur poshtë si e jashtë afatshme nga OSHP pas shqyrtimit dhe analizimit të të gjitha shkresave të lëndës. Ankuesi, ka parashtruar kërkesën për rishqyrtim jashtë afatit ligjor, sepse me datën 24.12.2024 është publikuar vendimi i AK-së për anulim ndërsa kërkesa për rishqyrtim është parashtruar me datën 31.12.2024, që njëherësh ankesa është konsideruar jashtë afatit ligjor prej 5 ditësh për dorëzim të KR kundër B58.

Operatori ekonomik “DWH-Kosova” SH.P.K me datën 13.01.2025 ka parashtruar kerkese per rishqyrtim ne AK (për te cilën nuk ka vendim te AK-se), ndërkaq me datën 17.01.2025, ka parashtruar sërish ankesë në OSHP me numër protokoli 2025/0053.

- Vlerësimi dhe administrimi i provave –

Nga provat e prezantuara vërtetohet se OE “DWH-Kosova” SH.P.K ka parashtruar ankesë të palejuar sepse për të njëjtin aktivitet të prokurimit autoriteti kontraktues ka publikuar vendimin për anulim të aktivitetit të prokurimit me datën 24.12.2024 dhe nga ky vendim, më AK nuk ka publikuar vendim tjetër për të cilin OE do kishte mundur të ankohej dhe të zhvillonte procedurat sipas nenit 108/A dhe nenit 109 te LPP-se.

Sqarojmë se kundër vendimit për anulim të Komunës së Suharekës OE “DWH-Kosova” SH.P.K ka parashtruar kërkesë për rishqyrtim me datën 31.12.2024, dhe ankesë në OSHP me datën 07.01.2025, e cila është hedhur si e jashtë afatshme, për shkak se kërkesa për rishqyrtim në AK është parashtruar jashtë afatit ligjor që është i përcaktuar me nenin 60 pika 1 të Rregullores për Prokurimin Publik.

Operatori ekonomik “DWH-Kosova” SH.P.K, ka parashtruar sërish kërkesë për rishqyrtim në AK- KK Suharekë me datën 13.01.2025, për të cilën nuk ka vendim nga AK të ngarkuar në platformën e e-prokurimit.

OSHP sqaron se kundër çdo vendimi të marrë nga autoriteti kontraktues në përputhje me rrethanat e nenit 108/A paragrafi 7, çdo palë e interesuar mund të parashtrojë ankesë pranë OSHP-së, pas udhëheqjes së një procedure paraprake për zgjidhje të mosmarrëveshjes në përputhje me nenin 108/A të këtij ligji.

Andaj nga provat e prezantuara dhe rrjedha e këtij aktiviteti të prokurimit konstatohet se kërkesa për rishqyrtim e parashtruar në Autoritetin Kontraktues me datën 13.01.2025 është e palejuar, për faktin se OE kundër vendimit për anulim të datës 24.12.2024, tashme ka shtjerrur mjetin juridik, pra të drejtën e ankesës, dhe nuk ka pasur vendim të ri të AK-së për çka edhe ka mundur të

ankohej përsëri.

Duke qenë kështu, OSHP konsideron se ankesa e parashtruar në OSHP me datën 17.01.2025 me numër të protokollit 2025/0053 është e palejuar dhe në kundërshtim me nenin 109 të LPP-së.

Autoriteti kontraktues – Komuna e Suharekës, mund të vazhdojë më tutje me aktivitetin e prokurimit “Blerja e paisjes për matje te gjeodezike për nevojat e drejtorisë” me numër prokurimi 624-24-10705-1-3-6, përkitazi me këtë ankesë, nëse nuk ka ndonjë ankesë tjetër për këtë aktivitet të prokurimit.

Po ashtu zyra për pranimin e ankesave ka konstatuar se ankuesi ka paraqitur dëshmi për pagesën e tarifës me rastin e parashtrimin të ankesës në OSHP tarifë kjo e cila kthehet konform nenit 31 par 4 i Rregullores së Punës së OSHP-së.

UD. Udhëheqës i Sekretariatit, duke u bazuar në atë që u tha si më lartë, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.



Këshillë juridike:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi ka të drejtë t'i drejtohet Gjykatës Komerciale në Prishtinë, në afat prej 30 ditësh nga data e pranimi të këtij vendimi.

Vendimi t'i dorëzohet:

- **AK - KOMUNA SUHAREKË**
- **OE - DWH-KOSOVA SH.P.K.**
- Arkivës së OSHP-së: